

**RENDI I DITËS**

**Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 81, me subjekt ankues: Koalicioni  
“Bashkë Fitojmë” si dhe kërkesës ankimore nr. 86, me subjekt ankues: Partia  
Lëvizja e Legalitetit.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. D. Alimemeti
- **Parti Politike:** BF (Z. Franci Nuri)
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Lako:** Atëherë, e riçelim seancën për shpalljen e vendimit mbi ankimet për Bashkinë Kamëz. Bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, në mbështetje të nenit 21 shkronja “b” dhe 143 pika 1 shkronja “d” të Kodit Zgjedhor, KAS me shumicë votash vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 81 datë 23.05.2023 të paraqitura nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
- Pranimin e kërkesës ankimore nr. 86 datë 25.05.2023, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Legalitetit.
- Ndryshimin e vendimit nr. 536 datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë Kamëz në zgjedhjet për organet e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas tabelës përmbledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS të datës 01.06.2023.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

- U shpall sot në 07.06.2023!

Me kaq e deklarojmë të mbyllur këtë seancë.

**Vendimi nr. 176**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**7.06.2023  
Ora 11.11**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 85”, subjekti ankues  
Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, objekti: Rinumërim dhe rivlerësim i votave të QV-  
ve nr. 2373/01 dhe nr. 2483/00 Elbasan**

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. D. Alimehmeti
- **Parti politike** BF (F. Nuri, B. Himçi)
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Riçelim seancën për shqyrtimin administrativ për kërkesën ankimore nr. 85, me objekt ankimi “Kundërshtimin e vendimit 539, datë 20.5.2023 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë dhe për këshillin e bashkisë zona zgjedhore Bashkia Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan dhe përsëritjen e zgjedhjeve”. Të pranishëm janë përfaqësuesit e subjektit ankimes koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

**Z. F. Nuri:** Franci Nuri, prezent.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Blendi Himçi, prezent.

**Z. L. Braho:** Po ashtu prezent është edhe përfaqësuesi i palës së interesuar, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. M. Legisi:** Avokat Maringlen Legisi.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! I pranishëm është edhe sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Po ashtu trupa e KAS-it e plotë. Ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët?

**Z. F. Nuri:** Kërkesa, nëse do ta konsiderojmë paraprake, është e njëjta kërkesë, i nderuar zoti relator, që ne ngritëm edhe dje në rastin identik për Kamzën, kërkojmë që të merret në konsideratë në këtë shqyrtim edhe çështja e respektimit ose jo të vendimit të Rregullatorit, vendimit të datës 13 nëntor 2020 në lidhje me karakteristikat e vetë pajisjeve PEVN. Ne gjykojmë që ky standard dhe këto karakteristika teknike nuk janë zbatuar në këto zgjedhje në të gjitha qendrat e votimit edhe në Bashkinë e Elbasanit dhe kërkojmë që edhe kjo çështje të shqyrtohet nga KAS-i për të thelluar hetimin administrativ dhe për këqyrur nëse është zbatuar pikë për pikë çdo element detyrues që Rregullatori ka imponuar për pajisjet PEVN. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Kam një pyetje në lidhje me këtë argument tuajin, po e marrim si argument, se akti është akt i Komisionit Rregullator, nuk është provë, është akt normativ. Ju nëpërmjet këtij pretendimi që pajisja e votimit elektronik nuk bënte konfirmimin e versionit fizik të fletës së votimit. Këtë e keni si argument për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në çdo qendër votimi të Bashkisë Elbasan?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

konfirmimin e versionit fizik të fletës së votimit. Këtë e keni si argument për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në çdo qendër votimi të Bashkisë Elbasan?

**Z. F. Nuri:** Po. E saktë. Po e ngremë në shtesë të argumenteve të tjera për shkelje të tjera zgjedhore që janë kryer në Bashkinë e Elbasanit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Kanë ndonjë pyetje kolegët në lidhje me këtë? Atëherë, zoti sekretar i Përgjithshëm, çfarë mund të na thoni në lidhje me këtë pretendim, që në ndryshim nga specifikimet teknike që janë miratuar në vitin 2020 për pajisjet e votimit elektronik, pajisjet që janë përdorur në zgjedhjet e vitit 2023 nuk japin mundësinë të konfirmohet edhe fleta fizike që printon pajisja. A është e vërtetë kjo? Si ka qenë në zgjedhjet e vitit 2021 kjo procedurë?

**Z. Y. Merkaç:** Duke qenë se është çështje teknike, do të flas drejtoresha e IT-së për këtë.

**Znj. D. Alimemeti:** Në këto zgjedhje pajisjet kanë qenë të njëjta me pajisjet e vitit 2021, i njëjti lloj, i njëjti brend. Konfigurimet kanë ndryshuar vetëm për pjesën e votimit për deputet dhe në këtë rast për zgjedhjet lokale. Fakti është që këtu kemi pasur dy fletë votimi dhe pas ndryshimeve që mund të bënte votuesi, konfirmimin ose të ndryshimit në variantin elektronik, mund ta verifikonte e ta konfirmonte me sy fletën e votimit. Nuk ka pasur një buton ose një procedurë që ta anulonte këtë fletë votimi, fletën e printuar po flas. Por i gjithë procesi mund të bëhej dhe mund të zgjidhej që në momentin e parë kur votuesi zgjedh në pajisje votën e tij, mund ta ndryshojë e mund ta konfirmojë atë herë sa e mendon këtë pjesë. Ndryshimet kanë ardhur për arsye ju thashë të vendosjes së dy fletëve njëra pas tjetrës. Kjo është

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

procedurë teknike dhe konfirmimi bëhej me sy në fund të procesit të votimit. Gjithsesi, kjo nuk hedh poshtë asnjë nga elementet, asnjë nga proceset që unë zgjedh A-në dhe me shfaqet A-ja dhe zgjedh B-në dhe më shfaqet B-ja. Gjithashtu, të gjitha votat, siç u vunë re, janë të përputhura 100% me dhënien e rezultatit dhe transmetimin e të dhënave.

**Z. L. Braho:** Unë jam i qartë për atë që ju sqaruat, por tani e kam pyetjen ekzaktësisht për sekretarin e Përgjithshëm: meqenëse teknikisht sipas drejtoreshës ka qenë e pamundur që të bëhej ky anulim i fletës fizike, a është përkthyer kjo në një akt normativ nga ana e Rregullatorit për këto zgjedhje, apo akti normativ vijon të jetë ai i vitit 2021, ndërkohë që rregullat teknike janë të ndryshme?

**Z. Y. Merkaj:** Akti vazhdon të jetë ai i vitit 2021, por rregullat teknike janë të njëjta, nuk janë të ndryshme. E njëjta gjë është.

**Z. I. Rusmali:** Unë kam ende paqartësi për shpjegimin. Ju shpjegoni që për shkak se ishin dy fletë votimi në këtë proces, u detyruat të hiqnit dorë nga procedura e anulimit të fletës fizike, por nuk na keni shpjeguar pse. Fakti që janë dy fletë votimi nuk na thotë ndonjë gjë. Pse dy fletë votimi jua prishin skemën?

**Znj. D. Alimemeti:** Sepse në fund të votimit, pas zgjedhjes së të dy alternativave, në qoftë se unë do ta anuloja, më printohen të dyja fletët njëra pas tjetrës dhe nuk kam mundësi që të anulojë njërin e të shfaqë të dytën. Kjo është arsyeja teknike, do të thotë që në momentin që unë zgjedh, bëj zgjedhjet e mia, në fund fare kam butonin “aktivizo” ose “printo”. Printimi lidhet me printimin e dy fletëve të votimit dhe në

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

qoftë se unë anuloj të parën, por duhet të zgjedh të dytën, nuk më jepet teknikisht mundësia.

**Z. I. Rusmali:** Opsioni “Printo” nuk mund të vendosej pas çdo votimi?

**Znj. D. Alimemeti:** Është vendosur në fund të të dy fletëve.

**Z. I. Rusmali:** Nuk mund të vendosej pas çdo votimi?

**Znj. D. Alimemeti:** Me kohën që kemi pasur, jo. Në kohën e konfigurimit të fletës së votimit dhe të tërë...

**Z. I. Rusmali:** Ju u detyruat të konfiguroni gjithçka në një kohë të shkurtër dhe nuk arritët dot, nuk ka lidhje me kohën e votimit, që po të ishin njëra pas tjetrës vonohej koha e votimit?

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, ka lidhje me kohën e konfigurimit.

**Z. F. Nuri:** Nëse mund të bëj ndonjë pyetje tjetër. Nga ajo që kuptuam dhe nga përgjigjet e sekretarit të Përgjithshëm apo të administratës së KQZ-së rezulton që vetë akti në fjalë i Rregullatorit mund të ketë pësuar ndryshime, por kjo pjesë na u konfirmua që ky detyrim i parashikuar te pika 10, germa “k” nuk paska pësuar ndryshime, si detyrim ligjor mbetet i vlefshëm edhe për këto zgjedhje. Kjo është pika e parë. Pika e dytë që unë kuptova nga ajo që u parashtrua edhe nga drejtoresha është se për arsye teknike, duke qenë se janë dy fletë votimi, ishte ndoshta e vështirë ose e pamundur për kohën që ju kishit që të kryhej ndarja meqenëse ishin dy fleta,

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

që të mund të anulohet pas printimit, apo jo? Isha i qartë? Në aspektin teknik ajo mund të zgjidhet fare kollaj, ku të dyja fletët printoheshin së bashku në një shirit ndoshta, mendoj unë.

**Z. L. Braho:** Është negociuar me kompaninë mundësia që këto specifikime...

**Znj. D. Alimemeti:** Po, patjetër.

**Z. L. Braho:** Ka pasur një negociatë...

**Znj. D. Alimemeti:** Ka pasur një negociatë me kompaninë për konfigurimin në ndarje, le të themi, por koha e konfigurimit që kishim në dispozicion, e konfigurimit të fletës dhe e mënyrës si do të ishte procesi në kutinë e votimit, në pajisjen PEVN është rënë dakord për këtë procedurë. Në fund të kësaj ne shtypnin “printo” dhe printonim dy fletë të ndara të votimit. Në lidhje me një fletë, nuk mund të bashkohen dhe nuk mund të kemi të dyja fletët e votimit në një. Nuk bëhet.

**Z. F. Nuri:** Edhe një pyetje tjetër që më lindi nga shpjegimet tuaja, a mund të na i vini në dispozicion ose neve ose edhe KAS-it komunikimet që ju keni pasur si KQZ me kompaninë pikërisht për këtë proces? Meraku që ne kemi, besoj edhe shqetësimi i publikut, është a i ka ofruar KQZ-ja garancitë që vetë Rregullatori ka parashikuar në lidhje me votimin elektronik? Zgjedhësve u është dhënë mundësia që të kenë po ato garanci që Kodi garanton edhe për zgjedhjet me fletë votimi normale, sepse dua ta rikujtoj për të gjithë që në fletët e votimit normale, nëse personi gabon, mund të kërkojë një fletë të dytë. A janë dhënë këto garanci në këtë rast me votimin elektronik kësaj radhe?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Më fal, por nuk është kështu.

**Z. K. Bele:** Një kujtesë të vogël, të njëjtën gjë që kanë bërë edhe dje. Avokat, sjell në vëmendje që në këtë proces ne po çmojmë zgjedhjet në Elbasan, jo historinë e vendosjes së votimit elektronik në Shqipëri. Ai është një proces i zgjidhur politikisht, i dakordësuar politikisht, i miratuar në ligj, është pilot, mund të ketë probleme që do të diskutohen në reformat e tjera, dikush mund të jetë pro, dikush mund të jetë kundër. Unë nuk do të isha pro votimit elektronik, dikush mund ta mendojë ndryshe, por kjo ka pak rëndësi. Ai është një proces që është vendosur me ligj, ka bërë atë rrugë që ka bërë, ka një vendim të rregullatorit ku subjektet politike janë të përfaqësuara në këtë pikë. Ne jemi mbledhur për të diskutuar çfarë ka ndodhur ditën e votimit. Ky është qëllimi i këtij procesi. Ne mund të diskutojmë pa fund lidhur me aktet e ndryshme si mund të kishin dalë, si mund të kishte qenë ndryshimi në ligj, çfarë modeli makinerie mund të kishte qenë. Nuk është ky qëllimi për të cilin jemi mbledhur. Kemi edhe një limit kohor. Do të doja të dilnit tek ajo për të cilën kemi ardhur sot.

**Z. F. Nuri:** Unë ju mirëkuptoj, zoti Bele, prandaj edhe ne i paraqitëm këto argumente, sepse pikërisht gjatë votimit në Elbasan ka qenë rasti i parë, në mos gaboj, në të gjithë Shqipërinë ku pati edhe ndërprerje të procesit të votimit pikërisht një komisioner, por edhe në një rast tjetër, një qytetar, në mos gaboj, konstatoi dhe pohoi publikisht se vota e tij nuk ishte printuar saktë nga zgjedhja që ai kishte bërë. Duke qenë se ne po merremi me pjesën a ka dhënë KQZ-ja garancitë teknike që vetë Rregullatori i ka parashikuar, mendoj se kjo është një çështje e rëndësishme dhe lidhet drejtpërdrejt me rastin e Elbasanit, sepse pikërisht nga ato raste që u bënë

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

publike ne arritëm të ngremë këtë ankim. Nëse nuk do të kishin ndodhur ato raste, ndoshta nuk do të ishim sot këtu.

**Z. K. Bele:** Pretendimi i një qytetari për një veprim që ai e ka kryer ose jo, nuk mund të vendosë në pikëpyetje një sistem zgjedhor dhe nuk mund të jetë provë fakti që një qytetar del nga dhoma e fshehtë dhe thotë unë bëra këtë veprim, por nuk më doli siç e bëra unë. Arsyet që ka qytetari mund të jenë të ndryshme, mund të dalin 10 qytetarë që mund të pretendojnë gjëra të çuditshme, siç ndonjëherë pretendojnë që kanë takuar edhe ufot, por kjo nuk do të thotë që ne do të mjaftohemi e do të mbajmë peng një shqyrtim lidhur me një pretendim të një qytetari. Le të adresohet në forma të ndryshme. Duhet të jemi seriozë e t'i japim një zgjidhje procesit.

**Z. F. Nuri:** Jam dakord që nuk mund të ngrihemi thjesht nga disa elemente sporadike, por unë insistoj te pika që vetë Rregullatori e ka shënuar. Në qoftë se kjo garanci, germa “k” që votuesit duhet t'i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i një zgjedhje të bërë, përfshirë edhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës, është dhënë më përpara dhe vijon të jetë akoma në fuqi sot e kësaj dite, ka pasur besoj një arsye pse duhet të jepej kjo garanci, që edhe kur printohej personi ta shihte dhe të jepte konfirmimin edhe pas printimit. Besoj se ka pasur një arsye pse është dhënë ajo garanci, pikërisht për të shmangur këto raste që mund të kenë ndodhur. Megjithatë, ju do ta vlerësoni. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Po, zoti Rusmali.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Unë jam i sigurt që avokati ndërkohë e ka harruar pyetjen që bëri, duke u marrë me përsiatjet dhe analizat ligjore apo faktike për problemin. Kjo është jashtë kontekstit. Ju keni negociuar me firmën. Me Rregullatorin a keni negociuar? Në kuptimin që a keni bërë përpjekje për të modifikuar germën “k”? Unë po pyes gjatë kohës që negocionin me firmën, me kompaninë, a negocionin edhe me Rregullatorin? Sepse mund të ketë pasur nevojë të koordinonin dy negociata me njëra-tjetrën.

**Z. Y. Merkaj:** Nuk është negociuar me Rregullatorin, nuk ka pasur kohë.

**Z. B. Himçi:** I gjithë thelbi i gjësë, pavarësisht u diskutua...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pyetja është: a janë zbatuar të gjitha pikat e Rregullatorit nga kompania dhe nëse jo, pse nuk ka pasur një referim nga ana e kompanisë për arsye se pse nuk zbatohet, pse nuk është bërë e ditur nga KQZ-ja që pikërisht kjo situatë nuk mund të rregullohet për arsye teknike dhe të rregullohej pastaj siç thoni ju. Për pikën 10, shkronja “k”.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ka një problem, i nderuar. Nuk është sqaruar, sepse këtu u diskutua që kemi rënë dakord në parim për pajisjen elektronike, për votimin elektronik. Pa diskutim që keni rënë dakord në përputhje me Rregullatorin, pa shkelur asgjë. Pse ndodh kjo? Sepse ne nuk i kemi dhënë garanci votuesit që pikërisht kur ndodhin të tilla anomali, siç mund të ishin situata të tilla në aspektin e votimit kur ai nuk ndihej i sigurt, mund ta kthente mbrapsht pjesën e votimit, ndoshta edhe pse kishte parë ufo. Në këtë lloj konteksti po e them që jepini garanci votuesit. E ka pasur Rregullatori. Drejtoresha e IT-së e KQZ-së thotë për çështje kohe. Unë nuk arrij të kuptoj çështjen e kohës me

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

atë që duhet të zbatonte me përpikëri në lidhje me Rregullatorin për t'i dhënë garanci votuesit. Këtu është shkelur e drejta e votuesit për një proces të rregullt. Nuk mund ta anashkalojmë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk është zbatuar germa “k” e pikës 10. Kjo është përgjigjja. Nuk të mjafton? Duhet negociuar edhe kjo? Nuk është zbatuar germa “k” e pikës 10, këtë kuptuam ne. Ju kuptuat gjë tjetër?

**Z. B. Himçi:** Zoti Rusmali, ajo që ju referoni dhe i referoheni thjesht me pika, germa “k”, pika 10, ka të bëjë me një element thelbësor, që i jep garanci votuesit.

**Z. L. Braho:** Zoti Himçi, të bëjmë një pyetje tjetër.

**Z. B. Himçi:** Pse nuk u gjet një zgjidhje tjetër teknike?

**Z. L. Braho:** Unë dua të kuptoj nëse na jep shpjegim sekretari i Përgjithshëm ose drejtoresha të anës subjektive të asaj germës “k”. Parashikimi në germën “k” ka qenë që të parandaloheshin këto rastet kur ti votoje për x dhe vota dilte për y fizikisht, apo ka qenë për rastin kur votuesi e bënte të gjithë procesin dhe nuk pendohej për votën te votimi elektronik, por pendohej në momentin kur printohej fleta.

**Znj. D. Alimemeti:** Ky ishte si element sigurie shtesë, le të themi, do të thotë që ti të kishe mundësi pjesë e anulimit të të verifikonte sasinë e votës, ta kishte një element shtesë sigurie në pjesën fizike, por kjo gjë është rregulluar në pjesën elektronike.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** Ky është element sigurie, apo element të vullnetit të votuesit që votuesi e kuptonte te printimi fizik që kishte votuar për dikë?

**Z. Y. Merhaj:** Është element i shtuar, tepër i shtuar, se po ta marrësh me Kodin Zgjedhor dhe me votimin që është bërë sivjet, është e njëjta procedurë. Votimi sivjet është përshtatur me nenin 107, pika 2, të Kodit Zgjedhor. Zgjedhësit i kthehet vetëm kur dëmton fletën e votimit. Po e hodhi në kuti, nuk e kthen dot mbrapsht. Kur dëmtohet fleta, mund t'i jepet një fletë tjetër votuesit. Po e hodhi në kuti, nuk e kthen dot. E njëjta procedurë është edhe këtu, e shtype te ekrani, e bëre konfirmimin. Ka qenë një element i shtuar, e ka tejkaluar Kodin Zgjedhor.

**Z. E Çefa:** Unë kam një pyetje për ta materializuar, për ta kuptuar, për administratën. Në qoftë se do të ishte aplikuar rregulli i parashikuar në vendimin nr. 4 të Rregullatorit në pikën 10, germa "k", a do të ishin evituar rastet që ankuesi i referoi, që votues të caktuar janë ankuar për tjetërsim të votës në procesin e printimit? Pse nuk ka lidhje, mund të ma shpjegoni?

**Znj. D. Alimemeti:** Konfirmimin ju e merrni që në fillim, e shikon, e konfirmon, është e njëjta procedurë, që në zgjedhjen elektronike të gjësë e konfirmon, është logjika e procesit, ti e shikon informacionin tek printeri, nuk do të bënte asnjë ndryshim.

**Z. E. Çefa:** Nuk dua të bëj debat, por nga sa diskutojmë, ne e kemi kaluar këtë fazë, personi e ka aplikuar ose jo ndryshimin e votës elektronikisht, nuk ka pasur ankime apo pretendime deri në këtë fazë. Kur është printuar fleta e votimit, ka thënë unë votova për subjektin A, printimi doli për subjektin B. Pyetja është: nëse garancia e

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

parashikuar nga germa “k” e pikës 10 të vendimit të Rregullatorit do të ishte aplikuar, personi, besoj unë, do të kishte mundësi që këtë pretendim ta ndryshonte edhe në atë fazë e për rrjedhojë nuk do ta ngrinte më këtë problem, nuk do të thoshte dot u printua ndryshe fleta e votimit, apo jo.

**Znj. D. Alimemeti:** Nuk do të ndodhte në herë të parë, nuk ndodh që të zgjedh njërën e të printoj tjetrën.

**Z. E. Çefa:** Ky është opinionimi juaj, nuk ndodh.

**Z. D. Alimehmeti:** Nuk themi ne, është fakt.

**Z. E. Çefa:** Siç thoni ju nuk ndodh, thotë ai tjetri më ka ndodhur. Ju bëni be, ai bën be, tani si ta ndajmë këtë. Unë po të pyes detaje teknike.

**Z. D. Alimehmeti:** E kuptoj. Kjo gjëja mund të zgjidhej fare mirë nëse zotërinjtë do të ishin gjatë testimit operacional. Mund të hidhni një sasi të caktuar votash dhe të testonin të gjitha elementet që nga pajisja dhe çfarë merrej në sistem, e në databaza.

**Z. E. Çefa:** Testi ngelet test, që do të thotë se bëhet me një numër kampion.

**Z. D. Alimehmeti:** Më falni, informacioni që merret gjatë pjesës së testimit ka të njëjtën *software*, është i njëjti aplikacion që zbatohet dhe, përveç 3%, zgjidhen në mënyrë të rastësishme pajisjet në zonat...

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. E. Çefa:** E di shumë mirë. E kuptoj shumë mirë. Testi është probabilitet, nuk do të thotë që, meqë e testove një gjë, nuk ndodh asnjë problemi, se e kemi testuar më përpara. Testimi do të thotë që probabilitetisht kjo pajisje shkon mirë dhe në pjesën më të madhe të specifikimeve teknike e kryen punën për të cilën është blerë, por kjo nuk do të thotë që nuk ka raste përjashtimore. Rastet përjashtimore bëhen nëpërmjet garancisë së vënë në germën “k” të nenit 10 të vendimit të Rregullatorit, pra, në qoftë se do të ishte e mundur teknikisht edhe në këto votime, printimi i fletës së votimit dhe ndryshimi në fazën e printimit, ne nuk do të kishim asnjë rast dhe asnjë pretendim nga asnjë person që unë votova për A-në dhe në printim më doli B. Duke mos u aplikuar kjo garanci shtesë, e parashikuar në dispozitën e Rregullatorit, atëherë kemi këto raste që duam apo nuk duam ne, se sa e njollosin apo jo procesin, është tjetër histori. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Unë nuk dua të mbjell mjegull në këtë diskutim, nuk dua të merrem me rastin e ngjarë, sepse në vlerësimin tim rasti i ngjarë është verifikuar dhe provuar jashtë çdo lloj dyshimi. Ka pasur seanca të tjera të mëparshme KAS-i që të merrej me të. Unë dua të kuptoj këtë kundërvënie të praktikës suaj me aktin normativ, se ky është diskutimi i palës, në mos gaboj. Konfirmimi që i bëhet votimit me këtë procedurën e re, ndodh përpara printimit të fletës së votimit, apo konfirmimi bëhet pasi shihet fleta e votimit dhe pastaj bëhet konfirmimi? Si e ka procedura?

**Znj. D. Alimemeti:** Jepet komanda “printo”, konfirmimi kryhet përpara. Jepet komanda “printo” dhe votuesi mund ta këqyrë, mund ta shikojë fletën që të dyja fletët që bien, bie në fillim fleta e parë për kryetar dhe pastaj fleta e dytë për këshill.

**Z. I. Rusmali:** Ato bien automatikisht?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Jepet kohë, ndriçohet ekrani i printerit dhe i jepet kohë, diku te 5 sekonda.

**Z. I. Rusmali:** Pra, ka 5 sekonda kohë për të verifikuar printin, por nuk ka asnjë mundësi teknike të ndikojë mbi procesin. Procesin e vet e ka të mbyllur.

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë, nëse nuk ka pyetje të tjera, nuk e di pala a ka ndonjë provë tjetër? Nëse jo, t'i japim fund hetimit administrativ dhe të kalojmë në konkluzione.

**Z. B. Himçi:** I nderuar, para se t'i jepni fund hetimit administrativ, kemi ende dy momente të pasqaruara nga KQZ-ja. U la si detyrë nga ana juaj t'iu ktheheshin përgjigje për 30 qendrat e KZAZ-së 47 për të cilat ende nuk kemi marrë përgjigje, për shkeljet në lidhje me kodet e sigurisë, vulat e sigurisë dhe kodet e papërdorura për çdo qendër.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pikërisht për këtë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, kjo që si kërkesë paraprake dhe prandaj. Dhe së dyti, ju i patët lënë detyrë KQZ-së në seancën e parë në lidhje me pyetjet përkatëse për të cilat KQZ-ja ende nuk ka kthyer përgjigje zyrtare këtij procesi.

**Z. L. Braho:** Po fjala është për përfaqësuesit e KQZ-së, së pari, për procesverbalet.

**Znj. D. Alimemeti:** Së pari, në lidhje me plotësimin e procesverbaleve, u vlerësuan edhe të dhënat që morëm nga zotërinjtë në lidhje me QV-të e evidentuara, dhe unë

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

ju thashë paraprakisht që sasia më e madhe e QV-ve janë përdorur është përdorur vetëm një kuti, QV, më falni, të cilat janë referuar, 12 QV janë të papërdorura kanë të përdorur vetëm një pajisje, pajisja e dytë nuk është përdorur. Për pjesën tjetër ka le të themi pajisje, të cilat nuk kanë të mbyllur materialet zgjedhore, kutinë e materialeve zgjedhore, janë 5 QV; ka pajisje, të cilave iu mungon kodi i printerit si në rastin e Kamzës, janë 4 të tilla; një QV, nuk ekziston fare, mbase është një lapsus i shkruar gabimisht numri i QV-së ose ka ndonjë gjë. Gjithashtu, ka edhe 7 QV, të cilat thonë që mungon kodi, por ndërkohë janë të gjitha kodet në procesverbal dhe nuk e di ku janë referuar apo çfarë, duken të rregullta le të themi.

**Z. I. Rusmali:** Provat i keni në dorë, krahasojini me njeri-tjetrin.

**Znj. D. Alimemeti:** Janë të njëjtat procesverbale që ne iu kemi vënë në dispozicion, ne kemi origjinalet dhe i kemi vënë në dispozicion.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Z. B. Himçi:** Tani, nuk vëmë pikëpyetje përgjegjshmërinë tonë, apo papërgjegjshmërinë e drejtoreshës, por më vjen keq, se ne i jemi referuar çdo procesverbali të mbajtur nga ana e KZAZ-së. Tani të vihet dhe të thuhet këtu...

*(Diskutime pa mikrofon)*

I nderuar, më vjen keq, por janë aty.

Po sigurisht. Ia kemi vënë në dispozicion.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Patjetër, po, dalim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** 2391-shi, ka kutinë e votimit, këtu është deklaruar si e pavulosur, e padorëzuar, ndërkohë këtë ka vendosur kutinë shoqëruese të votimit janë me kodet 014901; 014929; 014904; 014930 dhe e printerit 04999, gjithashtu, ka të vendosur kutinë shoqëruese të votimit PEVN2 është e vulosur me 5 kode sigurie, 014 902; 014 906; 014 925; 014 909 dhe 014 894. Ka të vendosur një element që thotë “pa dorëzuar” dhe pastaj ka “dorëzuar” 010 112, janë të vendosur dy vulat, le të themi, dhe thotë kutia “është e rregullt” dhe kutia e materialeve zgjedhore ka të vendosur të gjitha kodet.

**Z. L. Braho:** Më falni, na sqaro pak, çfarë ndryshimi ka kodi i sigurisë nga vula?

**Znj. D. Alimemeti:** Njëlloj, kodi i sigurisë është sipër vulës, është e njëjta gjë.

**Z. L. Braho:** Këto pajisjet elektronike së bashku me printerin sa vula sa kode sigurie kanë?

**Znj. D. Alimemeti:** Kuti në vetvete ka 4 plus vulën e printerit ka 5, kutia shoqëruese dhe pajisja.

**Z. L. Braho:** Kuti e fletëve fizike. Po pajisja?

**Znj. D. Alimehmeti:** Pajisja ka të *usb*-së dhe mbyllet edhe me një valixhe.

**Z. L. Braho:** Tani kjo e *usb*-së rri e mbyllur të gjithë kohën?

**Znj. D. Alimehmeti:** Po rri e mbyllur të gjithë kohën

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** Pra nuk ka punë KQV-ja me atë.

**Znj D. Alimehmeti:** Jo, nuk ka, vetëm në momentin kur përcillet informacioni.

**Z. L. Braho:** Këto që lexuat ju deri tani i kanë pasur të gjitha pra 5 kodet e kutisë së sigurisë kutisë fizike edhe kodin e *usb*-së.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Z. B. Himçi:** Atëherë në pajisjen PEVN, te pika e dytë e këtij procesverbali, thuhet për 2391-shin, për këtë diskutove drejtoreshë, pajisja PEVN1 fole *usb* është vulosur me vulë metalike me kod sigurie, në të djathtë shkruhet “pa dorëzuar” dhe thuhet një kod i korigjuar 004937 dhe te PEVN2 po e njëjta “pa e dorëzuar” 090747. Pastaj thuhet në të dy krahët “dorëzuar” vetëm me një kod tjetër 010 112, kurse për këtë pjesën tjetër nuk thuhet dorëzuar por është prapë “e pa dorëzuar” dhe ka vënë një kod tjetër 010113. Pretendimi yt është që është i rregullt. Tani këtu në procesverbal thuhet “pa dorëzuar:” dhe ne që e konstatojmë në procesverbal që thuhet “i padorëzuar”.

**Znj. D. Alimemeti:** “Pa dorëzuar” dhe keni vendosur kodet e sigurisë, si? Kur s’është është e padorëzuar nuk do të kishte një kod sigurie. Në dijeninë time ka një kod sigurie ajo vule e vendosur. Tani unë nuk e di se nuk kam qenë në momentin kur është bërë dorëzimi.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** A mund të sqaroj diçka. Në momentin që dorëzohet nga Komisioni i Qendrës së Votimit në KZAZ, ngrihen grupet e marrjes në dorëzim. Grupet e marrjes në dorëzim, në momentin që merret në dorëzim, e shpall kutinë ose të parregullt ose të rregullt. Grupi i Numërimit përbëhen nga dy anëtarë, një është i pozitës një është i opozitës, që ka qenë një anëtar i grupit të marrjes në dorëzim nga përfaqësuesit e palës ankuese. Nuk e kanë shënuar. Po ta shkruash të parregullt nuk e merr në dorëzim, nuk numërohet, nuk futet në numërim. Në këtë rast i kanë marrë të gjitha të rregullta.

**Z. L. Braho:** Tani pretendimi...

**Z. I. Rusmali:** Çfarë do të thotë “e padorëzuar”? Ai po lexon fjalën pa dorëzuar, shpjegoni çfarë do të thotë pa dorëzuar?

**Z. Y. Merkaj:** “E padorëzuar” do të thotë nuk e kanë vendosur atë e kanë marrë në dorëzim si të rregullt, sepse komisioni i marrjes në dorëzim dhe komisioni i KZAZ-së i përbërë nga 7 anëtarë, ku shumica ka qenë e përfaqësuesit të opozitës nuk e kanë quajtur të parregullt.

**Z. L. Braho:** Koalicioni, një anëtar KZAZ-je ka pasur.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioni ka pasur 7 anëtarë.

**Z. L. Braho:** Dakord, por koalicioni që është subjekt ankues këtu ka pasur një anëtar në KZAZ.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Kodi Zgjedhor i ka krijuar mundësitë që KZAZ-të janë me numër çift ose tek. Në këtë ka qenë shumicë opozita. Nënkrjetari ka qenë i opozitës, apo (*nuk dëgjohet*)... i famshëm që doli dhe denoncoi.

**Z. L. Braho:** Edhe njëherë Ylli, se nuk po kuptohemi. Pra, më lër të flas, koalicioni ka pasur një përfaqësues, në dijeninë time në KZAZ.

**Z. Y. Mrkaj:** KQZ-ja ka dhe përfaqësues të opozitës, nuk e dimë si është, por 4 janë të opozitës.

**Z. L. Braho:** Po mirë e di. Por ka bërë ankim ky subjekt, nuk ka bërë e gjithë opozita.

**Z. Y. Merkaj:** Atje KZAZ-ja i ka marrë të gjitha të rregullta.

**Z. L. Braho:** Shumë mirë, mund të kenë lajthitur ata të KZAZ-së, i kanë marrë. Tani këto shënime, procesverbalin ne duam t'i kuptojmë. Kjo është e gjitha. Meqenëse pala po ngre pretendime, ne duam të japim përgjigje me vendim.

**Z. Y. Merko:** Atëherë grupi i marrjes në dorëzim dhe KZAZ-ja në mungesë të një kodi sigurie të vendosur atje e ka quajtur të rregullt dhe nuk ka ndikuar në integritetin e kutisë së votimit. Ky është shpjegimi që i japim ne.

**Z. L. Braho:** Po, kush mungon kjo e *usb*-së apo një nga kutia në këtë rast?  
(*Diskutime pa mikrofon*)

Çfarë ndikimi mund të ketë në integritetin e pajisjes, mungesa e vulës së *usb*-së?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Unë po shoh procesverbalin. Në procesverbal, dhe këtu besoj jeni dakord të dyja palët, ka shënimin për pajisjen e PEVN1-shit folenë e *usb*-së “pa dorëzuar”, ka për PEVN2, “pa dorëzuar” dhe pastaj është bërë shënimi, korrigjimi po të doni, “dorëzuar” dhe janë vendosur janë shkruar kode sigurie. Është kjo gjëja, apo jo? Kjo do të thotë se jemi në situatën e një procesverbali me korrigjim, apo jo?  
*(Diskutime pa mikrofon)*

Pa dorëzuar është korrigjuar. Të mos themi me deklaram pa dorëzuar, por procesverbal i korrigjuar. Tani ju keni të gjithë të drejtën të çmoni nga këndvështrimi ligjor, korrigjimin e procesverbalit, ata kanë të drejtën të thonë korrigjimi është i rregullt apo i parregullt. Por jemi duke diskutuar procesverbalin me korrigjim. Dakord? A mund ta bëjmë këtë analizë për të 7 procesverbalet?

**Znj. D. Alimemeti:** Raste të ngjashme me këtë janë 394, është shkruar pa vulë, pastaj është vendosur vula, a jemi në rregull?

**Z. B. Himçi:** Është tjetër gjë korrigjuar dhe tjetër gjë pa vulë.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, pa vulë është 394.

**Z. B. Himçi:** Një pyetje të cilën zoti Braho e bëri dhe për të cilën jemi të interesuar edhe ne në funksion të kësaj pyetje. Kur ka mungesë vule apo mungesë kodi sigurie kjo *usb* paraqet?

**Z. I. Rusmali:** Ju lutem!

**Z. B. Himçi:** Unë po bëj pyetje.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Ju lutem shumë, ne duhet të konstatojmë faktin përpara. Mbi faktin ngremë analiza dhe pretendime. Fakti është që është shënuar pa vulë, ndërkohë që në këqyrje rezulton që vula është vënë. Eventualisht mbrapa. Kaq është fakti. T'i eliminojmë faktet pastaj të bëjmë analizat, pastaj të ngremë pretendimet mbi gjërat, por nuk mund të diskutojmë mbi faktet, bëjmë debat mbi faktet. Fakti është është shënuar pa vulë, është vendosur vula, vula ekziston.

**Z. B. Himçi:** Tani është vendosur kod sigurie, janë dy gjëra. Kod sigurie dhe vulë, por nuk mund të themi tani....

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Ta këqyrim dhe këtë tjetrën. Nxirre dhe këtë tjetrën ta shohim.

**Z. B. Himçi:** 2394.

**Z. I. Rusmali:** Në të njëjtën situatë ndodhet shënimi në të njëjtin vend, praktikisht, *usb*, te pajisjet PEVN 1 dhe PEVN 2 në secilin rresht prej tyre është bërë shënimi "pa vulë" dhe në krah është vendosur 011096 aq sa mund t'i lexoj unë numrat, 011089. A është ky fakti?

**Z. B. Himçi:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Dakord kalojmë tek tjetra.

**Znj. D. Alimemeti:** 2470.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. B. Himçi:** Më falni një sekondë, ne ramë dakord që t'i analizonim një e nga një për të na dhënë dhe sqarimet përkatëse. Tani prapë po i përmblihdni dhe po i nxirrni tani. Unë e kuptoj afatin kohor për t'i rënë shkurt dhe për të mbaruar punë, por tani nuk mund të vazhdohet kështu.

**Z. L. Braho:** Nuk po i biem shkurt.

**Z. I. Rusmali:** Është shumë e thjeshtë, po fiksojmë faktet.

**Z. L. Braho:** Ilirjan, të lutem më lër të flas! Atëherë do t'i sqarojmë një nga një të gjitha procesverbalet për të cilat ju keni ngritur pretendime. Te secila do të na thuhet çfarë mungon ose çfarë pretendoni ju se mungon dhe drejtoresha do të na thotë çfarë ndodh në procesverbal, të na japë shpjegimet një nga një.

**Znj. D. Alimemeti:** Te 2470 është përsëri e njëjta tipologji, në vendin ku është parashikuar të vendoset vula e *usb*-së thotë pa vulë dhe pastaj ka të vendosur dy elemente të tjera.

**Z. I. Rusmali:** Cilat janë elementët e tjerë na i lexo, ju lutem!

**Znj. D. Alimemeti:** "Pa vulë" te 003253, është kodi, dhe pastaj është 011089; 2396 mungon një nga vulat vula e katërt e kutisë së materialeve zgjedhore që është tjetër tipologji.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** Kutia e materialeve zgjedhore është e njëjtë si te elektroniket? Pra, i njëjti format kutie është që ka 4 kode dhe mungon një nga kodet.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo, vetëm këtë, do të thotë janë 3 kode dhe mungon i katërti. 2441-shi “e papërdorur” është rasti që specifikuam më përpara.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kutia një pajisje është e papërdorur.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është e papërdorur do të thotë kanë përdorur për votim vetëm një makineri, vetëm një pajisje PEVN, janë dërguar dy, por është përdorur vetëm një. 2422/1 është e njëjta gjë. Ky rast është pa vulë fare. Rasti tipologjia e parë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pajisja PEVN, foleja *usb*, është e vulosur me vulë metalike dhe thotë “pa vulë”, nuk ka të vendosur kodet e sigurisë.

**Z. L. Braho:** Çfarë do të thotë e vulosur me vulë metalike, por pa vulë?

**Znj. D. Alimemeti:** Është emërtimi, nuk është e vulosur.

**Z. L. Braho:** Pra, nuk ka vulë prapë te *usb*-ja.

**Znj. D. Alimemeti:** 2426 mungojnë dy kodet e kutisë së materialeve zgjedhore. 2479 mungojnë kodet e kutisë së materialeve zgjedhore përsëri. Nuk ka kode fare. Kutia është e hapur vulosur me vulë rezervë thotë 013 336. Kutia materialeve zgjedhore për qendrën 2479; 2416 është përsëri thotë pa vulë për *usb*-të dhe ka të vendosur pastaj numrin e vulave 004940 dhe 000648. 0398, është e papërdorur; 2463 është

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

e papërdorur; 23951, është përsëri rasti pa vulë, ku ka të vendosur në krah vulat 011083 dhe 011030. 2385 është përdorur vetëm një kuti, një PEVN. Rasti tjetër 2394 nuk kanë të vendosur dy kodet e printerit. Kutia, mungon kodi i pestë tek kutia e printerit.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po, te printeri ka 4, të kutia shoqëruese ka 4 vula, dhe një që mbyll pjesën e printerit që diskutuam, rasti i Kamzës.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Z. Y. Merkaç:** Është vlerësimi i KZAZ-së.

**Znj. D. Alimemeti:** 2471 mungojnë prapë vulat e printerit; 2410 është e papërdorur; 2415 është e papërdorur; 2439 është e papërdorur; 2446 është e papërdorur.

**Z. B. Himçi:** 2446, thatë e papërdorur? Ne këtu e kemi shënuar te fleta që mungojnë 4 vula, te kjo... Çfarë do të thotë kjo, a mund të na e shpjegoni pak? Pra, mungojnë 4 vula te 2446, te rreshti 20 te kjo fleta. Pra te rreshti parë është shënuar mungojnë 4 vula. Pra, te rreshti 20 kolona e parë anash komentit, mungojnë 4 vula..

**Znj. D. Alimemeti:** Është kuti e hapur, mungon 4 vula të tjera do të thotë që kanë përdorur vetëm një kuti. Pra nuk kanë përdorur dy pajisje për të vulosur është vulosur vetëm 1.

**Z. B. Himçi:** Këtu anash te kolona e komentit e treta thuhet “pa vulë PEVN2”.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** Po mungon dhe të ketë në krah pa vulosur të ka vulosur vetëm një pajisje dhe këtu thotë pa vulosur, nëse e shikon.

**Z. B. Himçi:** Unë kam komentin, ato të tjera, po 4 vula mungojnë.

**Znj. D. Alimemeti:** Jo 4 vula mungojnë, është e hapur, është kuti bosh do të thotë, është e papërdorur. 2390/1, edhe kjo është e papërdorur; 2450, është rasti, tipologjia e parë ku thotë “pa vulosur” dhe pastaj ka kodet e sigurisë që janë 011 055 dhe 033071; 2456 është e njëjta gjë, “pa vulosur” dhe pastaj ka të vendosur kodet 011029 dhe 011087. “E papërdorur” për 2449, “e papërdorur” për 2384, “e papërdorur” për 2379; “mungon vula e katërt” te kutia e materialeve zgjedhore për 247401, për 2480 mungon kodet e printerit.

**Z. B. Himçi:** 5 kodet e printerit është komentuar këtu.

**Z. D. Alimehmeti:** Jo kodi i pestë, do të thotë është një kod printeri një vulë.

**Z. B. Himçi:** Atëherë, duhet ta korrigjoni sepse këtu lexon mungojnë 5 kode.

**Znj. D. Alimemeti:** Është e juaja ajo.

**Z. B. Himçi:** Kjo është e juaja?

**Znj. D. Alimehmeti:** Po. 2480 thanë që mungojnë kodet e printerit, 2479 mungojnë përsëri kodet e printerit.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ndjesë, kodi.

Këto ishin.

**Z. L. Braho:** Tani pala a u qartësua, a keni ndonjë pyetje?

**Z. B. Himçi:** Vetëm që komentet e palës këtu nuk ka qartësi, sepse ne jemi para një fakti, pyetja që bëhet, që e orientuat edhe ju, i nderuar, ishte që këto kuti pa kode ose pa vula të *usb*-së.

**Z. L. Braho:** Po, pra tani ju kanë thënë ju që me argumentet tuaja të pretendoni që 1,2,3,4, ose 5 kuti kanë qenë të parregullta.

**Z. B. Himçi:** Jo, në këndvështrimin tonë janë të 30-ta të parregullta.

**Z. L. Braho:** Tani unë kam një pyetje për këto që janë të papërdorura, çfarë supozohet me të papërdorura? Ajo është marrë nga KQV-ja, nuk është hapur fare valixhja, apo është hapur valixhja?

**Znj. D Alimehmeti:** Nëse mbani mend rastin e Kamzës një nga kutitë ishte bosh, ishte ky rasti nuk është përdorur për votim fare, është marrë pajisja dhe nuk është vënë në funksionim.

**Z. L. Braho:** Si sigurohemi ne që kjo pajisja nuk ka transmetuar rezultat?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Znj. D. Alimemeti:** *Usb*-ja nëse vendoset në pajisje nuk njihet, kur nuk hapet procesi, kur vendoset le të themi në server ose në laptopin e përshtatur për këtë transmetim, nuk njihet *usb*-ja jep mesazh gabim, nëse nuk është hapur votimi.

**Z. L. Braho:** Shumë teknike kjo dhe ajo që unë kam të paqartë, është dakord nuk është vënë në funksionim kjo pajisje, supozohet vulat duhet të jenë njësoj për pajisjen, pra vulat duhet të jenë të pandryshuara.

(Diskutime pa mikrofon)

Vulat i vendos komisioni, por, nëse nuk i ka përdorur pse duhet t'i heqin vula për t'i vënë vula asaj? Këtë nuk kuptoj unë.

**Znj. D. Alimemeti:** Mbase nga që nuk është përdorur nuk ka vendosur asnjë vulë? Mund të jetë...

**Z. B. Himçi:** Ndoshta administrata e KQZ-së mund të na sqarojë pse ndodhin këto problematika me vulat në tërësi dhe me kodet *usb*? A mund të jetë për shkak të transportit edhe kjo si puna e kamerave, apo është përgjegjësi e operatorëve, apo si shpjegohet?

**Z. Y. Merkaç:** Kjo është përgjegjësia e operatori, duhet at kishin mbyllur atë. Ndoshta nga trajnimi i dobët nuk e kanë kuptuar dhe nuk e kanë mbyllur. Për këto që është përdorur një pajisje e kanë pasur që nga votimi që ka shumë pak zgjedhës dhe komisioni e ka vlerësuar abstenim. Qendra e votimit Plangaricë ka pasur 30-40 zgjedhës dhe e kanë vlerësuar si të panevojshme për të hapur PEVN-në. Ka pasur dy pajisje, por ka përdorur një pajisje.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** Operatori ç'hyn te pjesa e *usb*-së, sepse *usb*-ja nuk është fare në funksion të *KQV*-së, *usb*-ja është vetëm *KZAZ*-ja në momentin e rezultatit.

**Z. Y. Merkaç:** Në qendrën e votimit janë dy operatorë një që përdor pajisjen *PEI* dhe një që përdor pajisjen *PEVN*. Operatori para se të fillojë votimi i vendos kodin te foleja e *usb*, e mbyll, nuk e ka mbyllur e ka lënë ashtu. Flasim për qendrën e votimit në momentin që hapet qendra e votimit në 7 të mëngjesit.

(Diskutime pa mikrofon)

Atje është operatori. Atëherë, pajisjet *PEVN* kanë shkuar nga *KQZ*-ja në qendrat e votimit.

**Z. L. Braho:** Meqë ka qenë e pavulosur që në *KQZ*.

**Z. Y. Merkaç:** Që nga *KQZ*-ja ka vajtur e pavulosur dhe ishte ideja që do ta vuloste operatori në orën 7 të mëngjesit kur hapet votimi. S'e ka vulosur, s'e ka ditur, s'e ka kuptuar dhe i ka lënë pa vulosur dhe kur ka vajtur *KZAZ*-ja, *KZAZ*-ja i thotë vulose dhe ka i vendosur vulën. Kanë qenë me dakordësinë e të dyja palëve, në dyja anët edhe nga *KQV* -ja, edhe nga *KZAZ*-ja.

**Z. B. Himçi:** Besoj që ato duhet të kishin ardhur me kode sigurie, pra pajisja duhet të vinte me kode sigurie, nuk mund të lihet e hapur, sepse mund të ishte pjesë e abuzimit të votimit para se të hapej kutia, ora dhe ora e votimit. Pra, në këtë pikëpamje gjëja e parë që pretendojnë palët është që paska ardhur pa kode sigurie dhe pa vulë sigurie pajisja. Për mua është moment që ju duhet ta vlerësoni. Pjesa tjetër, tani unë do të kërkoja pak përgjegjshmëri më të plotë, të nderuar anëtarë të *KAS*-it, nga ana e *KQZ*-së dhe drejtoreshës, sigurisht që i tërheq vëmendjen për këtë

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.7.06.2023*

lloj gjëje, sepse tani t'ju sjellë informacion totalisht të gabuar dhe thotë 24-46 është e rregullt, ndërkohë në procesverbal konstatohet, në qoftë se më lejoni kjo kuti e dytë është e parregullt, në procesverbal; deklarohet gjithashtu mungojnë 4 vula të tjera, kutia e hapur. Tani thuhet te pajisja PEVN 2 foleja e USB-së e vulosur me vulë metalike është e pavulosur. Mund t'jua vë në dispozicion.

**Z. F. Nuri:** Është ajo që dhe unë relatova qëparë për mungesën e 4 vulave.

**Z. L. Braho:** Kjo kutia e parregullt që është QV 24 -46 është përlllogaritur në rezultate?

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë ta sqaroj edhe një herë, në çdo qendër votimi ka 2 PEVN, 2 kuti dhe 2 printera. Domethënë ajo kur nuk është përdorur PEVN-ja, ka qenë kutia e hapur, nuk është mbyll fare, sepse s'ka pas nevojë të mbyllet, sepse s'ka punuar PEVN-ja dhe s'ka pse ta mbylli një kuti me kode sigurie, kur kutia është bosh. E ka dorëzuar siç e ka marrë, sepse është bosh s'ka fletë votimi.

**Z. L. Braho:** Tani kutia vulozet që në mëngjes, pra pa e ditur ti, a do përdorësh apo s'do ta përdorësh.

**Z. Y. Merkaç:** Jo, jo pra, e kanë ditur që nuk do ta përdorin, sepse janë pak zgjedhës janë 30, 40 zgjedhës çfarë do të bëjnë, të hapin 2 PEVN, hapi1.

**Z. L. Braho:** Aty mund të jenë votuar tërë ditën pa vula.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.7.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Jo, është *usb* që e tregon atë, nuk mundet, është edhe kutia. Duhet të lidhet me PEVN-në kutia.

**Z. L. Braho:** Kjo është kompetencë e KQV-së, a e hap një kuti, apo s'e hap, një pajisje e vë në funksion, apo s'e vë në funksion, është kompetencë KQV –së kjo?

**Z. Y. Merkaj:** Në një qendër votimi që janë 30 votues nuk ka pse ta hapë ai.

**Z. L. Braho:** Po pse keni çuar 2 atëherë, se ju e keni ditur që janë 30 votues.

**Z. Y. Merkaj:** I kemi çuar 2, sepse ashtu ka qenë rregulli. Nuk i vendosim ne atë, administrimin e bën Komisioni i Qendrës së Votimit.

**Znj. D. Alimemeti:** Në përcaktimin e rregullatorit është vendosur që do të dërgohen 2 pajisje për çdo QV.

**Z. Y. Merkaj:** Po Plangarica ka 130 zgjedhës, do të çonim 2, do të hapte 2. Po i kemi çuar 2 ne, po s'i ka hapur komisioni. Po tani kështu ka qenë orientimi.

**Z. B. Himçi:** Jo, jo nuk është kështu, për çdo qendër votimi ka rreth 1000 votues, ndryshe KQZ –ja mund të merrte vendim për bashkimin e 2 qendrave të votimit, kur ishin me numër më të pakët. Nuk ndodh kjo lloj gjëje. Domethënë tani kjo që thotë sekretari, në gjykimin tim, është abuzim ,që të pretendosh ti që të vijnë 30 apo 130 votues edhe nuk hapet, kur ti je në padijeni se sa do të vijnë. Domethënë të thuash këtë lloj gjëje mua më duket sinqerisht joserioze. Edhe interpretimet tani vijnë nga më të ndryshmet.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Mund të na i sillni këtu, t'i këqyrim kutitë e qendrës së votimit nr. 24-46. Të dyja kutitë, besoj që për kutinë e materialeve nuk keni ndonjë kuriozitet?

**Z. F. Nuri:** Pse jo.

**Z. L. Braho:** Çdo PEVN-në ka kuti materialesh më vete, apo 1 kuti materialesh është për të gjithë KQV-në?

**Znj. D. Alimemeti:** Për materialet zgjedhore është 1 për 2 PEVN.

**Z. L. Braho:** Është 1 për 2 PEVN.

**Z. I. Rusmali:** Franci, ke ndonjë kuriozitet për kutinë e materialeve?

**Z. F. Nuri:** Po, patjetër e marrim edhe atë në qoftë se nuk është problem.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, 3 kuti. Në qoftë se kanë tjetër për të diskutuar, diskutojmë edhe tjetër, po kjo njëherë, sepse kjo ka pasaktësi në procesverbal.

**Z. F. Nuri:** Janë pamjet filmike pastaj për t'u diskutuar.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Z. L. Braho:** E pezullojmë seancën 5 minuta që pala ankimuese të marrë kohë në qoftë se ka ndonjë kërkesë në lidhje me pajisjet fizike.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Rifillon seanca**

**Ora 12:23**

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 85 me ankues subjektin koalicioni “Bashkë Fitojmë”. I lamë kohë përfaqësuesit të ankuesve në qoftë se kanë ndonjë kërkesë tjetër.

**Z. B. Himçi:** Edhe një kërkesë tjetër për qendrën e votimit 2379.

**Z. L. Braho:** Po, çfarë ka kjo?

**Z. B. Himçi:** Te kjo kuti, te kutia e votimit nr. 2 thuhet e rregullt si kuti, thotë po pa e vulosur. Nuk ka asnjë vulë në këtë.

**Z. L. Braho:** Është përdorur kjo kuti?

**Z. B. Himçi:** Derisa ai thotë e rregullt, e rregullt është.

**Z. L. Braho:** Dakord, pra ishte 2446?

**Z. B. Himçi:** 2479, më fal, 2379.

**Z. L. Braho:** Tjetër keni kërkesë, jo. Mirë atëherë i kërkojmë administratës së KQZ –së që të na vërë në dispozicion kutitë e votimit, pajisjet PEI, dhe kutitë e materialeve zgjedhore për këto PEVN. Seancën do ta lemë për rreth 2 orë, zoti Merkaj?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Ka mundësi të vazhdojmë me diskutime të tjera?

**Z. L. Braho:** Mirë atëherë, ndërkohë që vijmë kutitë, ne vijojmë procesin me pretendimet e tjera që ka pala me provat me materiale filmike.


**Z. B. Himçi:** Nga harddisqet e jashtme të paktën në flash, se kemi shkarkuar vetëm sekuencat për sa u përket problematikave ku ka votim familjar, ndërhyrje të operatorit të pajisjes elektronike, në të cilën ka ndikuar ose ka votuar vetë ai personalisht për t'ju konstatuar si shkelje, të cilat kanë ndikuar në proces dhe kjo nuk është në aspektin sporadik. Por është edhe sistematike edhe sistemime, do të thosha, madje në çdo qendër votimi kemi të tillë situatë. Prandaj ju kërkohet që t'ju vija në dispozicion. Është një shqetësim shumë i madh i cili ka ndikuar, do të thosha, në votën e lirë, të fshehtë apo individuale.

**Z. L. Braho:** Këto janë të gjitha filmime nga qendrat e votimit.

**Z. B. Himçi:** Po, i nderuar, i kemi marrë të pandërprera, sigurisht që i kemi marrë me pamje nga sipërme, sepse në qoftë se do të ndërhyjmë pastaj do të thoshin edhe kjo si provë, kjo lloj sekuence, pastaj nuk do të kishte vlefshmërinë juridike. Gjithsesi ne i kemi edhe harddisqet e jashtme të pamjeve filmike të plota, por për efekt ekonomikiteti të procesit, ju kemi vënë në dispozicion me flash. Po ju kërkohet që t'ju vija në dispozicion për t'i parë.

**Z. I. Rusmali:** Praktika jonë është që ne i shqyrtojmë vetë pamjet video, por mund të kemi nevojë që ju të na bëni një përmbledhje, se besoj e keni një përmbledhje sa

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

 33

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

raste janë dhe çfarë tipologjie kanë. Në qoftë se e keni, do të ishte mirë të na e bëni ju këtu në seancë që ne pastaj ta kemi më të lehtë orientimin te shqyrtimi i pamjeve video.

**Z. B. Himçi:** I nderuar, për hir të së vërtetës, unë do t'ju jap vetëm një pjesë, sepse pamjet filmike janë konstatuar deri 4:30 të mëngjesit, ka qenë një situatë shumë voluminoze, të mos harrojmë që deri ditën e diel në drekë kemi arritur ta marrim totalisht të gjithë materialin. Gjithsesi unë kam bërë një përmbledhje të pjesëve kryesore në qendrat e votimit, por që ka ende në pjesën përshkuese pasi në qendrën e votimit 23-81 në pamjet filmike 06 QV04, numri i videos, ka filluar procesi, por është pjesërisht eurvejuar, në minutën e 11 e 1 kemi votim familjar, operatori dhe komisioni e lejojnë këtë proces. Qendra e votimit 23-81, një nga operatorët nuk duket qartë, operatori i PEV-së qëndron shumë afër monitorëve dhe orienton votuesin. Përsëri po në këtë qendër te pamjet filmike 12-QV-45 numri e videos, në minutën e 3:21 votohet në mënyrë kolektive dhe komisioni nuk merr asnjë masë dhe, gjithashtu, operatori i shikon shumë afër këto pjesë të procesit të votimit. Në minutën 4:30 vazhdon procesi i votimit dyshe pa mbajtur procesverbal nga ana e komisionit, gjë që edhe këtu kemi një shkelje tjetër në procesin e votimit. Në pamjet filmike 13 të po kësaj qendre, pra QV 05 anëtarët dhe operatori ndihmojnë votuesit duke parë monitorin nga afër dhe këtu flasim për minutat e videos nga minuta 19 deri ne 19:48. Përsëri po në të njëjtën qendër kemi në videon 13 QV 25 një nga vëzhguesit i afrohet dhe operatori PEVN lejon vëzhguesin që të ndihmojë votuesin, kjo në minutën 4:36. Në minutën 5:22 përsërit të njëjtin veprim me votuesin e radhës, i njëjti person ndihmon një votues tjetër në radhë. Në pamjet filmike, në videon po të kësaj qendre 13, qendra e votimit 45, votimi kryhet në një monitor nga 2 persona dhe në këtë lloj rasti nuk mbahet procesverbal, është minuta e 9:10. Gjithashtu kemi edhe në minutën

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

e 16:28, po të kësaj pamje filmike kemi votime në çift, ku komisioni lejon këtë shkelje. Në videon 14 QV 05 në minutën 18:31 po të kësaj qendre operatori asiston në votimin e qytetarit duke shtypur monitorin. Në minutën e 19-të, gjithashtu, një tjetër ndikim përsëri po e njëjta gjë nga operatori i PEV-së, pra vetëm në një qendër votimi, po e marr 23-81 konstatohen mbi 10 shkelje. Gjithashtu, në KZAZ-në 49 në qendrën e votimit 23-56 kamera është e fokusuar vetëm në pjesën e këmbëve, gjatë gjithë ditës së votimit, tek video 23 filmon vetëm 4 minuta dhe kamera fiket vetë. Në qendrën e votimit 23 -79 në Bradashesh në qendrën shëndetësore, në KZAZ-në 47 procesi i votimit është mbajtur në 2 ambiente të ndryshme. Komisioni është zhvendosur në ambientin e korridorit të hyrjes, ndërsa pajisja e votimit është vendosur në një nga dhomat e qendrës shëndetësore. Pra, kemi një raport të ndarjes, domethënë në tjetër vend është pajisja e votimit dhe në tjetër vend qëndron komisioni dhe kamera. Edhe kjo një shkelje tjetër, që është konstatuar nga pamjet filmike. Gjithashtu, operatori PEY largohet shumë herë radhazi dhe e lë pajisjen hapur shoqëruar me votuesit brenda, të cilët votojnë në mënyrë familjare. Në video 20-200-116-000 të kësaj qendre votimi dhe me numër video QV 24-71/1 në minutën 13:39 operatorja PEVN voton për qytetarin me dorën e saj, monitoruar shumë pastër nga kamerat, në fund kontrollon të fleta e votimit edhe rezultatin. Në minutën 14:25 i njëjti veprim përsëritet si në pikën e mësipërme. Në videon 20-200-16-000 në qendrën e votimit me numër video QV 56, po në këtë qendër votimi në minutën e parë një qytetar ndihmon pa procesverbal një votues. Kamera në këtë video vazhdimisht ka probleme me regjistrimin. Pajisjet janë të ngecura herë pas herë, kemi pamje të turbullta, ku është shumë e vështirë të identifikosh personat e komisionit. Në minutën 18 shikohet një votim familjar me disa persona. Po pamjet filmike 04 të QV 50, me numër video 04 QV 50 të qendrës votimit 24-81/1 pamjet janë të turbullta, fytyrat e anëtarëve të komisionit janë të paignifikueshme, çdo

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

veprim gjatë procesit është vështirë të konstatohet pasi pamjet janë shumë të turbullta. Në qendrën e votimit 24-76/2 kamerat e vendosura dhe janë gjysmë pamje, i gjithë procesi i votimit vazhdon kështu. Në videon 11 operatori ndërhyt të ndihmojë në minutën 8:08 minuta. Po në minutën 03:23 përsëri kemi votim familjar në këtë qendër. Në minutën e 16-të kemi votim kolektiv. Operatori PEVN ndërhyt në procedura që nuk ka as akses si, për shembull, marrja e kartës së ID-së duke kaluar tek anëtarët e komisionit dhe përsëri duke ndikuar në procesin e votimit. Në minutën 5 e 40 votimi familjar, vota shikohet edhe nga operatori PEVN, pavarësisht se kamera nuk i kap plotësisht 100% pamjet. Në minutën 9:05 operatori i pranishëm gjatë gjithë procesit të votimit duke parë plotësisht edhe votën e qytetarëve. Në minutën 12 operatori përsëri futet në proces votimi dhe asiston pothuajse gjatë gjithë kohës votuesit në çdo fillim të votimit. Në qendrën e votimit 24-74/1 në minutën e parë votimi është totalisht i parregullt, ku votuesit monitorojnë njëri-tjetrin në votim, të dy operatorët prezent. Vihet re që operatorja PEI shikon votimet e qytetarëve gjatë gjithë kohës, shkeljet e njëpasnjëshme të operatorit PEVN në çdo rast votimi, pamje të qarta dhe shumë të konstatueshme si në minutën 19:30 kemi votim kolektiv, pa mbajtje të procesverbalit, kemi pjesërisht të fokusuar në ambientet e votimit. Vëzhguesja qëndron afër monitorëve të pajisjes së votimit elektronik, ku shikon votën e votuesit. Minuta 08:35 të dy operatorët konfirmojnë rezultatin e votimit pasi qytetarët kanë votuar dhe janë larguar nga ambientet e votimit. Në minutën 5 operatori i tregon votuesit që duhet të bëjë zgjedhjen e kandidatit, duke treguar numër rendor të fleta e votimit; edhe te votuesja e radhës për të njëjtin veprim kemi të njëjtën situatë. Te qendra e votimit 24-73 nuk ka asnjë regjistrim, nuk është ndezur kamera. Në qendrën e votimit 24-72/1 nga pamjet e ambientit njëra nga pajisjet e votimit në monitor duket, kurse të tjetra jo. Përsëri kemi të njëjtën situatë të votuesit...

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** Zoti Himçi, pa dashur t'ju ndërpres.

**Z. B. Himçi:** Prandaj thashë është po e njëjta situatë.

**Z. L. Braho:** Ideja është ne thjesht na duhen tipologjitë jo të na përshkruash videot që do e shohim, tipologjinë dhe mos ke ndonjë statistikë,

**Z. B. Himçi:** Tipologjia i nderuar, pjesa më e madhe ka një rol jashtëzakonisht aktiv pothuajse në çdo qendër votimi operatori i pajisjes PEVN i cili ndikon gjatë gjithë procesit të moshat e treta, sidomos duke votuar ai ose duke ndikuar në votim, qoftë edhe me shenja gishtash në disa raste, duke treguar edhe 1-shin, për të votuar 1-shin dhe për të orientuar votuesin. Ky proces, i nderuar, e shikoj, e thashë edhe një herë tjetër, është një proces ndikimi në mënyrë sistematike dhe sistemime. Nuk mund të themi që me këto pesë vota apo këto pesë vota do të sillnin pavlefshmërinë e këtij procesi, apo jo. Unë do ta shikoj në një këndvështrim që i gjithë procesi ka qenë i ndikuar nga operatorët e pajisjes elektronike dhe këta operatorë në pjesën më të madhe kanë qenë o anëtarë të forumit Eurosocialist Shqiptar, ose familjarë të anëtarëve të Partisë Socialiste ose anëtarë të Partisë Socialiste. Pavarësisht se këto janë zgjedhur nga KQZ-ja, me idenë e aplikimit dhe ku ato duhet të bënin dhe të deklaronin që ishin pa parti, realisht ka ndodhur e kundërta, dhe sigurisht që ky proces ka bërë që të komprometohet pjesa e plotë e vendimmarrjes së secilit votues. Ka shkelur një nga liritë themelore të Kushtetutës siç është vota, që në Kushtetutë është e sanksionuar që është e fshehtë, individuale, dhe e pandikueshme. Vetëm këto 3 elemente të këtij votimi elektronik, nuk kanë ekzistuar pothuajse në çdo qendër

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

votimi. Prandaj do të kërkoja që edhe pamjet filmike ju ofrojnë një situatë shumë të qartë, do të thosha të kësaj që ne diskutojmë sot.

**Z. L. Braho:** Një pyetje sekretarit të Përgjithshëm. Zoti sekretar i Përgjithshëm, kush është marrë më rekrutimin e këtyre operatorëve të PEVN –ve?

**Z. Y. Merkaj:** Ne kemi hapur një aplikim. Ka pasur një aplikim që kanë aplikuar, kemi bërë thirrje për të aplikuar gjithë personat që mund të përdorin *smart phone* me lehtësi, me idenë që do të përdorej dhe për PEI dhe për PEVN-në. Janë hapur 2 aplikime dhe për PEI dhe për PEVN, kush ka aplikuar i kemi marrë dhe i kemi përzgjedhur. Në fakt, s'ka pasur kërkesa dhe nevojat kanë qenë pothuajse aty-aty.

**Z. L. Braho:** Kush ka pasur rol aktiv te përzgjedhja?

**Z. Y. Merkaj:** Po për PEI ka pasur drejtorja e IT-së në të dyja rastet, një ka qenë sektori i Eugenit dhe në rastin tjetër ka qenë drejtoresha e IT –së.

**Z. L. Braho:** Ka qenë kusht që këta duhet të ishin të depolitizuar?

**Z. Y. Merkaj:** Kusht nuk është, po unë dua një rast që të tregojë që është anëtar i partie një person, se nuk më rezulton asnjë nga këta. Të gjithë kanë qenë të rinj, shumica e këtyre.

**Z. L. Braho:** Pse janë të rinj s'do të thotë se janë pa parti.

**Z.Y. Merkaj:** Që përdorin mirë *smartphone* ...

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** E kuptoj, e kuptoj. Zoti Himçi.

**Z. B. Himçi:** Sekretari kërkoi një rast. Në qendrën e votimit të lagjes “Syrja Dylgjeri”, kemi nëna kryetare e komisionit dhe operatori i pajisjes elektronike të votimit elektronik është i biri.

**Z. Y. Merja:** Ky është nepotizëm, nuk është...

**Z. F. Nuri:** Në shtesë të kësaj që tha zoti Himçi, tek ankimi janë depozituar edhe disa emra konkretë, që janë punonjës të Bashkisë të Elbasanit, sugjeruar drejtpërdrejt nga Bashkia e Elbasanit në detyra të komisionerëve etj, etj, Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Zoti Merkaj, mund të na e prodhoni ju statistikën e rekrutimeve për Elbasanin. Sa aplikime ka pasur, sa janë rekrutuar? Se jua kërkuam edhe për Kamzën këtë, është mirë ta kemi.

**Z.Y. Merkaj:** Po, po e kemi gati, jua sjellim. Elbasanin e kemi gati, po edhe Kamzën, po ta doni, jua sjellim.

**Z. L. Braho:** Atëherë, zoti Himçi, keni ndonjë gjë tjetër në lidhje me provat, përpara se sa të vinë ato 2 kutitë?

**Z. B. Himçi:** Dhe në lidhje me detyrat që i latë ju KQZ –se në seancën e parë gjyqësore për shkresat, të cilat ende nuk kanë ardhur.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 7.06.2023*

**Z. L. Braho:** Nuk e di, unë mund të të jap atë përgjigje që dëgjova te Kamza, që janë përkthyer pyetjet

**Znj. D. Alimemeti:** I është kthyer përgjigje koalicionit “Bashkë Fitojmë”, dje në darkë ka ardhur përgjigja nga kompania dhe është përkthyer, i është bërë gati së bashku me raportin e kompanisë dhe me rezultatet e testit.

**Z. L. Braho:** Zoti Himçi, i paskeni ose më saktë i ka subjekti ankimues. Mbase duhet të bëni një komunikim të brendshëm dhe këtë kohën derisa të vijë kutitë ta shfrytëzoni dhe për ta analizuar këtë përgjigje. Zoti Nuri, ka ardhur përgjigja, apo?

**Z. F. Nuri:** Në hyrje të seancës na u vu në dispozicion një zarf nga administrata në lidhje me Kamzën.

**Z. L. Braho:** Tani meqë përmendët fjalën zarf, duhet ta hapni zarfin.

**Z. F. Nuri:** Po do ta shohim, mos kini merak.

**Z. Y. Merkaj:** Nuk është për Kamzën, është edhe për Elbasanin, duke qenë se janë *copy paste*, kërkesa dhe përgjigja, më shumë faqe ka arkitektura e pajisjes.

**Z. L. Braho:** Atëherë, në qoftë se, besoj se kërkon kohë, zoti Himçi, për këtë. Prova të tjera nuk prisni nga KZQ-ja, përveç atyre kutive. Mirë atëherë pezullojmë seancën. Ora është tani 12:45, në orën 15:00 rifillojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Rifillon Mbledhje**

**Ora 15:07**


**Z. L. Braho:** Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.85 me ankues subjektin zgjedhor “Koalicionin Bashkë Fitojmë” seanca u pezullua me qëllim pritjen e disa kutive të votimit që i përkasin zgjedhjeve për Bashkinë Elbasan. Kutitë kanë ardhur nga administrata e KQZ-së dhe do bëjmë verifikimet në raport me procesverbalet me të cilat janë marrë në dorëzim këto kuti nga KZAZ-ja për pjesën e vulave të sigurisë edhe kodeve.

**Z. I. Rusmali:** Procesverbalin në dorë dhe kqyrni kutinë, pala dhe KQZ.

**Z. L. Braho:** Këto kodet janë po ato besoj që kanë qenë nëpër procesverbale nuk janë prekur. Atëherë të dyja palët ose më saktë ankimuesi dhe pala e interesuar dhe administrata e KQZ-së të bëjnë kqyrjen e kutive, çfarë përputhet, çfarë nuk përputhet, çfarë mungon në mënyrë që secila palë të mbaj qendrimet e saj. Këto janë dy QV 2379, 2446. Pra, kutia që është e pa përdorur që është me qese i përket QV 2379, pra atje është përdorur vetëm një pajisje e votimit elektronik. Fletë votimi nuk kishte, kutia u hap dhe nuk ka fletë votim. Ndërkohë që ka kutia tjetër që është edhe kutia e përdorur. Zoti Himçi do e ndjekësh pak procesin. Ajo kutia tjetër që është e pa përdorur i përket QV 2446 pra të dyja qëndrat kanë nga një kuti të pa përdorur, ajo është bosh brenda ndërkohë që ka një vulë. Po zoti Himçi ju i kqyrët kutitë shihni ndonjë mos përputhje në mes të procesverbaleve dhe gjendjes faktike të këtyre kutive?

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Ne jemi të paqartë përsa i përket pjesës së pranisë a ka fletë votimi apo jo? Sepse në disa nga procesverbalet e mbajtura thuhet e pa

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

përdorshme dhe deri diku jemi dakord. Këtu nuk është shkruar e pa përdorshme në procesverbal por konstatohet që vetëm është e hapur dhe pa kode sigurie dhe sigurisht kutia mbetet bosh. Tani këtë të na e vërtetojë KQZ sepse në procesverbal nuk provohet që kjo pajisje nuk është përdorur. Ne nuk e dimë thjesht po ngremë një pyetje.

**Z. L. Braho:** Që të mos abuzojmë, kjo ka një mundësi tjetër për tu verifikuar sepse tek të gjitha këto qendra ka pasur edhe pajisje PEI, dhe nga pajisja PEI del numri i zgjedhësve që kanë votuar atë ditë. Në qoftë se numri i zgjedhësve që kanë votuar atë ditë, përputhet me rezultatin e asaj kutie që është përdorur, ne nuk mund të aludojmë që është përdorur edhe kjo tjetra dhe është boshatisur apo jo?

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Pa diskutim.


**Z. L. Braho:** Këtë besoj kemi mundësinë, që ta verifikojmë.

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Po, mund ta verifikojmë, të paktën ne nuk e administrojmë si provë, pjesën e paisjes PEI sepse ka qenë numri i votuesve për këtë qendër.

**Z. Y. Merkaj:** Tabelën përmbledhëse të rezultatit për çdo QV, gjejmë numrin e votuesve që kanë votuar. Dhe në qoftë se do KAS ne e hapim dhe i numërojmë dhe i shikojmë. Fletët e gjetura në kuti me numrin e zgjedhësve që kanë votuar.

**Z. L. Braho:** Ne mund ta bëjmë kështu, nxjerrim tabelën, që ju e keni, tabelën përmbledhëse hapim edhe shiriti i PEI ku ndodhet?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Nuk është, është në Lundër, janë kuti të tjera ato. Është proces shumë i gjatë.

**Z. L. Braho:** Jo, kur printohet shiriti, ai printohet edhe futet...

**Z. Y. Merkaj:** Janë kuti të tjera.

**Z. L. Braho:** Nuk është tek kutia e materialeve zgjedhore? Hapim edhe kutinë e materialeve zgjedhore që të shuajmë çdo dyshim,


**Z. Y. Merkaj:** Kemi tabelën e rezultateve për QV. QV 2446 ka 133 zgjedhës që kanë votuar. Kandidati i parë ka 84 vota, kandidati i dytë ka 49 vota, 133 vota. Nuk ka të pa vlefshme.

**Z. L. Braho:** Po tek QV 2379?

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Domethënë kutitë për 400 sepse sekretari kur komunikoi me juve tha që kanë qenë kutia të pa përdorura për 80 vota..

**Z. L. Braho:** Ky është pretendim tjetër sepse ky është pretendim pse është përdorur një kuti dhe nuk janë përdorur të dyja. Ky është pretendim tjetër që nuk ka lidhje me kodet.

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Më falni 409 në një kuti votimi, në një....

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*  


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Z. L. Braho:** Aty tek ajo kutia që po hapni vetëm na gjeni raportin e PEI.

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Ka një problem zoti Rusmali duhej të përputhej numri i fletëve të votimit në PEVN me numrin e pajisjes PEI. Pra çka do të thotë që një person...

**Z. I. Rusmali:** Janë probleme të ndryshme. Kemi dy kuti votimi dhe një rezultat. Pyetja është, është votuar tek të dyja apo vetëm tek njëra?! Përgjigja gjehet nga distina që është brenda, në këtë kuti votimi nxjerr distina kanë votuar kaq. Në qoftë se distina përputhet me tabelën mbyllet. **(Diskutim pa mikrofon, nuk dëgjohet mirë)**

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Nuk përputhet.

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se distina përputhet me tabelën do të thotë që kutia tjetër nuk është përdorur dhe heqim qafe kutinë tjetër. Në qoftë se nuk ka përputhje, pse nuk ka përputhje por kapen një nga një gjërat, jo të bëhen rrëmujë. Se po i bërë rrëmujë nuk zbulon asnjë gjë. Një nga një, e para është votuar në dy kuti apo në një kuti. Apo mendon skenarin me një kuti kanë votuar 132 tek tjetra ka votuar vetëm një njeri ky është skenari jot?

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Jo.

**Z. I. Rusmali:** Nuk është ky skenari jot në rregull.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Unë nuk e di, të cilët kanë qenë skenarët. Unë nuk mund ti përgjigjem skenarëve. Ti përgjigjet KQZ skenarëve. Unë di të them këtë që 132 në pajisjen PEI me 133 fleta votimi ka disproporcion qoftë edhe 1.


**Z. I. Rusmali:** Zoti Himçi është shumë e thjesht gjëja. Pyetja ishte në dy kuti apo në një kuti? Kësaj do ti japësh përgjigje. Pastaj kur të vijmë tek pyetja tjetër do ti japim përgjigje pyetjes tjetër. Deri kur ti ezaurojmë të gjitha pyetjet, mos të ngeli as një pyetje pa marrë përgjigje. ( **Diskutim pa mikrofon, nuk dëgjohe mirë!**)

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Pyetjet janë të lidhura zoti Rusmali. Janë të lidhura janë në korelacion me njëra tjetrën. Tani janë në koralcion çka do të thotë në 133 votues që pretendohet nga pajisja PEI, nga rezultati që ka nxjerrë KQZ dhe 132 që janë të pajisjes PEI do të thotë që ka diferencë votash.

**Z. Y. Merkaç:** Po njëri mund të ketë votuar manualisht dhe nuk i ka kapur shënjën e gishtave ndoshta, nuk e ka njohur. Atëherë, në kutinë e materialeve janë kuponat e PEI që mund ti numërojmë sipas numrit të zgjedhësve. Që mund ti numërojmë sa kanë votuar me gisht.

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Atëherë, të nderuar anëtarë të KAS në pajisjen PEI rezulton që janë 132 në përmbledhësen e pajisjes së votimit elektronik që është përdorur vetëm një pajisje rezulton që janë 133. Çka do të thotë, këtë përgjigje të na e japi KQZ, përfaqësuesit e KQZ-së.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Z. E. Dushallari:** Patjetër dy janë mundësitë, unë u mundova ta shpjegoja edhe më përpara. Mundësia e parë është, një zgjedhës ka ardhur, është identifikuar dhe identifikimi nuk është kryer plotësisht, deri në fund. Pra, pajisja nuk e ka llogaritur si identifikim të mbyllur, pra shenjën e gishtit nuk e ka lënë zotëria dhe është ndërprerë identifikimi. Ose mundësia tjetër e vetme është një zgjedhës ka votuar dy herë. Këto të dy mundësi janë.

**Z. B. Himçi, përfaqësues i BF-së:** Po mos e thuaj me kaq frikë, kjo është.

**Z. E. Dushallari:** Vetëm këto dy mundësi janë.

**Z. I. Rusmali:** A mundet ta verifikojmë nga kutia e fletëve të votimit.

**Z. L. Braho:** Të bëj edhe unë një pyetje, mund të ndodhi që mund të ketë qenë një nga komisionerët që ka votuar dhe thjesht nuk është shënuar emri tek regjistri i posaçëm?

**Z. E. Dushallari:** Kjo hynë tek rasti i parë që identifikimi nuk është kryer, nuk është rregjistruar.

**Z. L. Braho:** Më e mundshme është ajo që të ketë votuar një zgjedhës dy herë apo kjo që po themi ne.

**Z. Y. Merkaj:** Më e mundshme është që të ketë votuar operatori i PEVN-së pa kaluar tek pajisja PEI. Po të jetë zgjedhës i bashkisë po.

**Z. E. Dushallari:** Nga regjistrimi ka zero votues administratë zgjedhore. Pra, nuk është rregjistruar as operatori PEI as operatori i PEVN-së dhe as komisioni. Ka procedurë të veçantë për të rregjistruar administratën zgjedhore, e cila nuk e ka emrin tek ajo QV. Na duhet të kontrollojmë nëse operatori se ai i PEVN-së, si ai i PEI-it kanë qenë e kanë pasur emrin për të votuar në atë QV.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Numrat i kemi shumë kollaj, por si rregull, si rregull Komisioni i Qendrës së Votimit duhet të kishte bërë shënime te libri i protokollit të mbledhjeve.

**Z. I. Rusmali:** Libri nuk është i plotësuar, shënime nuk ka, ky është fakt. Tani hapim kutinë e votave të shohim çfarë ndodh.

**Z. L. Braho:** Atëhere u hap dhe kutia e fletëve të votimit dhe rezultati i kutisë së fletëve të votimit përputhet plotësisht me rezultatin e tabelës përmbledhëse që rezulton nga përcjellja e materialit elektronikisht.

**Z. Y. Merkaj:** Po, e gjeta, emri i operatorit të PEVN-së është Blerina Zeqir Brazhda. Janë të gjithë zgjedhës të kësaj Bashkie Elbasan, panvarësisht se janë në Qendra të ndryshme. Braho: Tani kalojmë me Qendrën e Votimit 23 79, atëhere te kutia, te Qendra e Votimit 23 79 kishim sërish një kuti votimi të papërdorur dhe bëjmë identifikimin e numrit të zgjedhësve në këtë Qendër Votimi.

**Z. I. Rusmali:** Nëqoftëse mund ta mbyllim konstatimin, te 24 46-ta procesverbali reflekton një kuti të parregullt, e cila ishte bosh, por nuk ishte e markuar si kuti e parregullt. Kqyrja provon faktin që në atë kuti nuk është votuar apo jo? Ndërkohë që në kutinë tjetër rezulton një votë më shumë, kjo është përmbledhja. Në fakt kutia bosh nëqoftëse është deklaruar e parregullt duhet të ishte markuar e parregullt. Nëse kjo ka vlerë për kërkesat e ankuesit është histori e tij, por kjo është gjëndja faktike. **Z. L. Braho:** Atëhere na duhet ta ndërpresim 5 minuta seancën se Policia Bashkiake po vendos gjoba në një vend që nuk vendosen gjoba, kështuqë duhet të lëvizim makinat. Atëhere vijojmë, u hap dhe kutia 23 79, më fal Qendra e

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

Votimit 23 79, materialet përputhen plotësisht, pra numri i zgjedhësve i paisjes PEI me rezultatin e paisjes PEVN, ku numri i votave të vlefshme plus votat e pavlefshme është i barabartë me numrin e zgjedhësve. Po.

**Z. B. Himçi:** E materialeve zgjedhore nuk është hapur ende, jam në pritje, nuk e kemi parë paisjen.

**Z. I. Rusmali:** Ne nuk morën përsipër të kontrollojmë gjithçka, ne morëm përsipër që të shohim, njëra kuti, ajo që është aty, është përdorur në procesin e votimit apo jo. Na rezulton që në atë kuti ndodhen 414 vota, aq saç rezulton në tabelën përmbledhëse të rezultateve, dhe bile numëruam dhe 414 vota për të qënë të sigurt, do të thotë që nëqoftëse në tabelë figurojnë 414 vota dhe në kuti gjenden 414 vota, ajo kuti nuk është përdorur. Pretendimi i drejtoreshës konfirmohet. Tani nëqoftëse ke kërkesë tjetër kalojmë në kërkesë tjetër.

**Z. L. Braho:** Jo lutem zoti Himçi, arsyeja që bën këtë verifikim ishte për të vërtetuar faktin a është përdorur apo s'është përdorur kutia pa vulë.

**Z. I. Rusmali:** Ajo që e provon nëse kjo kuti votimi ka patur fletë të tjera apo jo është paisja PEI, pra fleta e paisjes përmbledhëse e paisjes PEI konfirmon nëse ka patur më shumë votues apo më pak votues. Tani unë nuk e kuptoj pse ngurohet për këtë kur u hapën materialet zgjedhore për 24 46-ën dhe për këtë nuk u hapka, për 23 79-ën. Tani te materialet zgjedhore është vetëm përmbledhësi i paisjes PEI, tani nuk mund të përdorim dy praktika.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 07.06.2023*

**Z. L. Braho:** Hapni kutinë e materialeve dhe nxirrni vetëm atë shiritin e paisjes PEI ku është numri i votuesëve.

**Z. B. Himçi:** Unë kërkoj të kontrollohen të gjitha, procesverbali, konstatimet, libri i protokollit, distina, gjithçka, kështu verifikoni vulat bashkë me subjektin.

**Z. L. Braho:** Atëhere nga hapja e kutisë së materialeve zgjedhore për Qendrën 23 79, numri i zgjedhësve që kanë votuar është 414 dhe vërtetohet plotësisht me tabelën e rezultateve të miratuar për këtë Qendër Votimi. Pra përputhet numri i votuesëve me numrin e fletëve të gjetura në kutinë që ishte në

**Z. I. Rusmali:** Dhe konfirmohet fakti që është votuar një herë.

**Z. L. Braho:** Dhe konfirmohet fakti që është votuar vetëm me një kuti dhe kutia tjetër nuk është përdorur,

**Z. I. Rusmali:** Procesverbali i Qendrës së Votimit është i rregullt.

**Z. L. Braho:** I rregullt pra, procesverbali i Qendrës së Votimit është nënshkruar nga të shtatë anëtarët edhe nga paisja PEI rezulton po ashtu që kanë votuar 414 zgjedhës. Atëherë z. Himçi, pasi administruam dhe këto prova te fundit që u kërkuan nga ju. Nuk e di nëse keni ndonjë pretendim tjetër, po ashtu të mbyllim hetimin administrative dhe të vijojmë me konkluzionet përfundimtare.

**Z. B. Himçi:** Unë një pyetje kisha. A janë parë pamjet filmike nga ana juaj? Që të mbyllet hetimi besoj duhet të kishit vlerësuar.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Ne i shohim në dhomë këshillimi

**Z. L. Braho:** Kështu që nëse skeni gjë tjetër. Nuk keni gjë tjetër, atëherë I japim fund dhe hetimit administrativ dhe ftojmë palët për konkluzionet përfundimtare.

**Z. F. Nuri:** Në lidhje me rastin e votimit në Bashkinë Elbasan, ne sikur e kemi ngritur dhe më herët në seancat e kaluara por edhe sot paradite kundërshtojmë procesin zgjedhor për një sërë parregullësish dhe kërkojmë pavlefshmërinë e zgjedhjeve në bashkinë Elbasan si dhe ripërsëritjen e tyre. Një nga shkaqet që ne mendojmë se ka cënuar procesin dhe ka ceduar siguria e votimit është çështja e pajisjeve PEVN të cilat në gjykimin tonë dhe vlerësimin tonë nuk përmbushin të gjitha kriteret detyruese të vendosura nga Rregullatori në KQZ. Pra, nuk i ka dhënë garanci votuesit, të paktën ato garanci që ka patur votuesi herët e kaluara me këto pajisje që të mund ta kontrollonte dhe të mund ta konfirmonte votimi fizik pasi ai të ishte printuar në pajisje dhe të jepte komandën pozitive apo okejin duke e konfirmuar atë. Duke hequr nga këto pajisje për shkaqe teknike sikundër u kuptua sot në seancë ose për pamundësi teknike që të zgjidhej në rastin e këtyre zgjedhjeve duke qënë se paska patur dy fletë votimi . pra gjithsesi për aspekte teknike KQZ nuk arriti dot ta zgjidhë këtë çështje. Ne gjykojmë se nuk janë respektuar të gjitha standartet detyruese të imponuara nga Rregullatori në lidhje me garancitë që duhet të ofronin pajisjet PEVN. Në rastinë e Bashkisë së Elbasanit duke patur këto mangësi le të themi në sigurinë e votuesit për të votuar realisht kandidatin që ata kanë zgjedhur ne gjykojmë së procesi është i cënueshëm. Gjithsesi përtej kësaj kemi evidentuar nga provat që kemi paraqitur në aq pak kohë sa na është lënë në dispozicion për të kqyrur kamerat dhe materialet si

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

procesverbalet , kemi kqyrur dhe kemi vënë në dispozicion një listë të detajuar në qendra votimi ku ne shumicën e qendrave të votimit mbi 50% të rasteve të paktën kemi konstatuar votime familjare, votime në masë, shkelje të panumërta të procedurave të një procesi të rregullt të votimitn ndërhyrje seriale ndërhyrje do të thoja e gjithanshme e operatorëve që ishin aty pëe të asistuar personat e ndryshëm vunerabël ndoshta për të votuar , shkelje të çdolloj procedure rregulli të parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe aktet njerëzore. Këto kanë cënuar sekretin e votës, kanë cënuar patjetër sigurinë e votës, të drejtën e yotës individuale sikundër është parashikuar dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.169 datë 26.07.2002 dhe doja ta rithkesoja edhe njëherë këtë vendim për shkak se është mjaft I rëndësishëm sepse edhe herët e tjera ne e kemi ngritur shqetësimin se pse nuk kanë reaguar komisionerët tanë etj etj. Te ai gjykim është thënë ka qënë për zgjedhësin që ka votuar familjarisht dhe në atë gjykim është diçka interesante kur ka rezultuar se Komisionet e qendrave të votimit në kundërshtim me ligjin thotë Gjykata Kushtetuese kanë lejuar një marrëveshje të komisionerëve le të themi që zgjedhësit të mos votojnë në emër të familjarëve të tyre dhe jo vetëm kaq por kjo ka konsistuar në shkelje të rënda të ligjit duke cënuar komplet procesin zgjedhor. Në rastet që ne kemi pasur mundësi që t'i shqyrtojmë këtu sikundër është edhe rasti i Elbasanit ndonëse në procesverbale mund të ketë gjithmonë kontenstime kjo nuk e paragjykon faktin që mund të ketë patur edhe dakortësi të heshtur le të themi midis komisionerëve, këtë nuk mund ta paragjykojmë. Fakti se nuk është mbajtur shënim në librat e protokollit për çdo parregullësi që ka ndodhur aty mund të ketë pasur një konsensus të heshtur dhe ne nuk e dimë por thelbi i çështjes është a ka patur apo jo votim familjar, a ka patur apo jo votim me shkelje të procedurave, a ka qenë apo jo operatori i PEVN në zbatim të distancave 1 metër e gjysëm sikundër e kanë aktet nënligjore apo ai i shkel këto rregullave dhe afrohet bën veprime që nuk i lejoen

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

etj etj. Pra, ne në tërësi nga provat dhe nga faktet që kemi paraqitur demostrojmë që në pjesën më të madhe, në pjesën dërrmuese të qendrave të votimit në Elbasan janë shkelur procedurat e votimit të lirë, e votimit demokratik, e sekretit të votës dhe e drejta e qytetarit për të votuar në mënyrë individuale, pra për të votuar drejtpërdrejtë, por përkundrazi të tjerë persona i kanë ndikuar kanë qënë aty prezent duke ushtruar presione dhe pse jo mund të kenë manipuluar në raste të caktuara sikurse e vërtetojmë me prova filmike, se kane manipuluar ekranet ku nëpërmjet të cilave votohej duke cënuar besueshmërinë e procesit dhe sigurinë në tërësi të procesit zgjedhor. Për arsytet që këto shkelje kanë qënë masive dhe ju do t'i shikoni dhe nga pamjet filmike dhe nga materialet e tjera të vëna në dispozicion duke qënë se këto shkelje kanë qënë konstante dhe të gjithëanëshme në gjithë zonën e Bashkisë Elbasan, në të katërta KZAZ-të, ne gjykojmë se zgjedhjet duhen ripërsëritur. Po ja lë fjalën kolegut për...

**Z. B. Himçi:** Faleminderit Franci, së pari unë do kisha pasur dëshirë që para konkluzioneve përfundimtare, të paktën nga ju duhet të ishte parë dhe duhet të ishin analizuar të gjitha shkeljet në pamjet filmike, të cilët tregojnë për një proces totalisht të ndikuar ku kemi në mënyrë sistematike edhe sistemike siç e thashë dhe gjatë diskutimit të mëparshëm, të ndërhyrjes së operatorit PEI në porcesin e votimit, gjë që ka ndikuar në votën e lirë të fshehtë dhe sigurisht individuale, gjë që ma përforcon më shumë nga pamjet filmike nëqoftëse do ishin parë përsëri nga ju, do të shikonit votime familjare.

**Z. L. Braho:** Zoti Himçi, të lutem mos abuzojmë me këtë, ne do i shohim ato, nuk thamë që nuk do i shohim, konkluzione përfundimtare është fjala juaj nuk është fjala jonë, ne shprehemi me vendim dhe ne garantojmë që si në këtë proces dhe në

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

gjithë proceset e tjera që ka patur materiale filmike, ne i kemi parë para se të shprehemi me vendim

**Z. B. Himçi:** Në një proces administrativ para se të dilet me konkluzion përfundimtar, në funksion edhe të Kodit të Procedurave Administrative, sigurisht që duhet, që ta administroj duhet të ishin parë nga juve, qoftë në dhomë këshillimi. Megjithatë kjo është pjesë që ju përket ju dhe padiskutim që si pjesë e jona, me qëndrimet tona në lidhje me procesin elektronik në Elbasan thashë që ka së pari ndikim nga operatorët e paisjeve elektronike të cilët theksoj kanë qënë të lidhur ose anëtarë të forumit Eurosocialistë të Shqipërisë ose familjarë të anëtarëve të Partisë Socialiste ose vet anëtarë të Partisë Socialiste, të cilët kanë ardhur dhe janë përzgjedhur në KQZ nga një proces totalisht të padrejtë do të thoja, nga ana e KQZ-së, i cili pikërisht një nga pikat dhe kriteret kryesore ka qënë qëndrimi apartiak në lidhje me këtë pozicion të cilin ka punësuar KQZ-ja si operator të paisjeve të votimit elektronik. Nga ana tjetër, thashë, këtu kemi një shkelje tjetër të rëndë i cili është votimi familjar, të cilët kishin vite të cilët ishin shkëputur nga votimi familjar, nga votim që pothuajse ishte reduktuar, fatkeqësisht në votimin elektronik shohim shtim të votimit familjar, gjë, ashtu siç e shprehu dhe kolegu im, edhe në qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vitin 2002, me vendimin e saj ka patur dhe kemi një precedent, të nderuar anëtar të KAS-it, relator i KAS-it, kemi një precedent i cili ka bërë përsëritjen e zgjedhjeve kur ka patur votim familjar dhe ky votim familjar është në çdo qender votimi, prandaj them që duke iu referuar edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese që mund ta kemi si udhërrëfyes për të cilët atë që kërkojmë ne, kthimin dhe përsëritjen e zgjedhjeve për Bashkinë Elbasan. Një moment tjetër që u konstatua dhe në dy kuti u vlerësua 1. Përsëritja e votimit, më falni votimi, ku një person voton dy herë edhe ky është një problem

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.06.2023*

tjetër, për hir të të vërtetës nuk konstatohet vetëm në një qendër por edhe në pamjet filmike që do shikoni kemi rastin e kapur që një grua voton 3 herë e veshur ndryshe dhe pëesa i përket këtij rasti ne e kemi evidentuar dhe do ta keni përsëri në pamje filmike. Thënë ndryshe, janë përdorur të gjitha format e manipulimit të një procesi, çka do të thotë që të ndikohet ky proces për shkak të votimit familjar, për shkak të operatorit të paisjes elektronike, anëtar i Partisë Socialiste, apo të votimit më shumë sesa një herë në një qendër votimi apo në disa qendra votimi, kjo do të thotë që ky votim duhet të përsëritet për Bashkinë Elbasan. Ju faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Himçi, fjala për përaçësuesin e palës së interesuar të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Z. M. Legisi:** Faleminderit i nderuar nuk do ju mbajmë aspak, ne jemi shprehur përsa kemi prapësuar. Përfundimisht ne kërkojmë lënien në fuqi të vendimit 539, datë 25.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit për koncentrimin e vendimit tuaj, atëhere KAS do të tërhiqet për vendim. Vendimi do të shpallet nesër në datë 8 qershor, ora 13:15. Seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

